

VENDIM
Nr.526, datë 30.7.2004

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË INSPEKTORATIT TË INSTITUTEVE PRIVATE TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet “Kryeinspektor”, “Zëvendëskryeinspektor”, “Përgjegjës sektori”, “Inspektor” dhe “Specialist”, në Inspektoratin e Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1- Diplomë e shkollës së lartë, është 9000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind për çdo vit pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Punonjësit e tjerë të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare të paguhen sipas lidhjes II-5 “Pagat bazë sipas klasave për punonjësit e ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore”, miratuar me vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

7. Pagat e përcaktuara si më sipër të indeksohen sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr.74, datë 12.2.2004 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e indeksimit të pagave”, dhe në masën e përcaktuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

8. Këshillit të Ministrave, në buxhetin e miratua për vitin 2004, t’i shtohet fondi prej 7 000 000 (shtatë milionë) lekësh, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për Inspektoratin e Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, i cili të ndahet në zërat si më poshtë vijon:

- Zëri “Paga” 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë;
- Zëri “Sigurime shoqërore” 900 000 (nëntëqind mijë) lekë;
- Zëri “Investime” 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë;
- Zëri “Mallra dhe shërbime” 1 000 000 (një milion) lekë.

9. Numri i punonjësve të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare për vitin 2004, të jetë 10 veta.

10. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

	Paga mujore
--	-------------

Emërtimi	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4
	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Kryeinspektor	9 000	2%	0	90 000
Zëvendëskryeinspektor	9 000	2%	0	74 000
Përgjegjës sektori	9 000	2%	0	40 000
Inspektor	9 000	2%	0	30 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000